
RECENSIONE

**SALI KADRIA: NACIONALIZMI SHQIPTAR NË VITET 1912-1924,
Tiranë: Kristalina-KH, 2019, 680 f.**

Titulli i studimit tregon qartë që autori ka marrë përsipër një detyrë shkencore tepër ambicioze. Tema e nacionalizmit shqiptar në kohën vendimtare për krijimin dhe për mëvetësinë e shtetit shqiptar përmban disa drejtime kryesore - burimet ideologjike të nacionalizmit shqiptar, veprimet politike për pavarësimin e Shqipërisë, çështja e shqiptarëve jashtë shtetit shqiptar, politika dhe marrëdhëniet me Fuqitë e Mëdha, si edhe dimensione të tjera të shumta. Periudha e shqyrtuar (1912-1924) ka qenë plot e përplot me ngjarje dhe zhvillime të rëndësishme, të cilat nuk e kanë ndryshuar vetëm hartën politike në Gadishullin Ballkanik, por edhe në tërë kontinentin evropian. Përshkrimi, organizimi, analizimi dhe prezantimi i fakteve dhe i proceseve, të lidhura me temën e nacionalizmit shqiptar, kërkon përpjekje dhe aftësi të mëdha shkencore, sepse çdo autor do të ballafaqohet me sfida të shumta me karakter të ndryshëm. Duke e analizuar strukturën e punimit lexuesi kupton se dr. Sali Kadria ka një qasje serioze ndaj temës së përgjithshme, sepse tetë kapitujt e punimit përmbajnë tërë materialin dhe ndarja e tyre sipas periudhava ose sipas proceseve është e qëlluar. Edhe nënndarjet nëpër kapituj gjithashtu janë të qëlluara dhe nuk mund të ketë vërejtje në këtë aspekt.

Realizimi i këtij projekti madhor kërkon edhe përdorimin e *burimeve dhe të literaturës* shkencore përkatëse. Profesor Kadria i ka shfrytëzuar të gjithë arkivat relevantë në Shqipëri. Ka cituar dhe ka bërë krahasime me burime dhe literaturë nga autorë të huaj, që lejon qasjen kritike të studiuesit ndaj burimeve dhe hulumtimeve vendëse. Me rëndësi të madhe janë dokumentet arkivore, të përpiluara nga strukturat e Fuqive të Mëdha të asaj kohe - austro-hungareze, britanike, franceze, italiane, osmane, ruse etj., që janë përdorur si dokumente origjinale ose përmes botimeve dhe përmbledhjeve të tyre. Kujtimet e publikuara të veprimtarëve politikë prej asaj kohe janë shqyrtuar në mënyrë krahasore dhe kritike. Historiografia ballkanike gjithashtu është përdorur në mënyrë të mjaftueshme. Natyrisht, vëllimi i përgjithshëm i dokumenteve dhe i literaturës, të lidhura me temën dhe me periudhën, është tepër i madh dhe nuk ekziston

asnjë mundësi objektive të hulumtohet në “tërësi”. P. sh., në arkivat bullgare ekzistojnë qindra dokumente nga burime të ndryshme shtetërore dhe joshtetërore, të cilat përmbajnë fakte, informacione dhe analiza për proceset politike, pra për nacionalizmin shqiptar, në këtë periudhë. Falë këtyre dokumenteve në vitin 2019 u publikua edhe monografia e shkëlqyeshme e prof. Georgi Georgievit “Marrëdhëniet politike bullgaro-shqiptare (1908-1915)”. Prandaj, çdo “pretendim” eventual pse nuk është cituar ky ose ai autor dhe studim, do të ishte pa bazë.

Hyrja merret me shqyrtimin e koncepteve për nacionalizmin, që është me rëndësi të madhe për suksesin e tërë hulumtimit, sepse pa bazën adekuate teorike ai do të kthehej në një grumbull faktesh, duke e humbur vijën përmbajtësore. Nga ana tjetër, përpjekja eventuale për krijimin e një suaze të rreptë teorike do të krijonte telashe dhe probleme të shumta, sepse autorët dhe teoricienët perëndimorë i kanë krijuar konceptet e tyre kryesisht mbi bazën e historisë së kombeve perëndimore, derisa modeli shqiptar i nacionalizmit dhe i ndërtimit të kombit, në të vërtetë ka qenë një model tepër unik në krahasim jo vetëm me kombet perëndimore, por edhe me këto të fqinjëve ballkanikë. Autori u ka shpëtuar këtyre rreziqeve me krijimin e një koncepti të qartë dhe me përcaktimin e tipologjisë së nacionalizmit shqiptar pas analizës së fillesave të nacionalizmit shqiptar në kreun e parë të studimit. Pra, është një qasje shkencore, sepse bazohet mbi mendimet dhe faktet nga jeta politike dhe kulturore e shqiptarëve në shek. XIX, kur janë formësuar idetë kryesore të nacionalizmit të shqiptarët.

Në **kreun e parë**, *Nacionalizmi shqiptar si fenomen politik*, bëhet vështrim dhe analizë për fillesat dhe burimet e nacionalizmit shqiptar. Autori ka paraqitur të gjitha mendimet kryesore për fillesat e nacionalizmit shqiptar. Debate të tilla ende ka në çdo historiografi ballkanike, sepse në të vërtetë është e vështirë të caktohet ndonjë datë, madje edhe dekadë e veçantë kur nacionalizmi është bërë ideologji kryesore, sepse studiuesit e ndryshëm bazohen mbi fakte dhe procese me prapavijë kulturore, arsimore, politike etj. Me çdo kusht, përcaktimi i ndonjë kufiri kohor është relativ. Periodizimi i etapeve të nacionalizmit shqiptar, që është bërë në faqet 25-26, është argumentuar mirë dhe arsyeton edhe temën kryesore të studimit. Përkufizimi i termave në këtë kapitull është shumë i dobishëm sa i përket karakterit teorik të hulumtimit. Mund të pajtohem plotësisht edhe me konkluzionin bosht në këtë kapitull, pra për karakterin difensiv të nacionalizmit shqiptar, sepse,

siç provohet nga faktet e paraqitura, ai u pozicionua në mbrojtje të integritetit territorial të Shqipërisë dhe jo në programe ekspansioniste.

Në **kreun e dytë** analizohen problemet, të lidhura me krijimin, mbrojtjen dhe përpjekjet e dëshpëruara për mbijetesën e shtetit të sapolindur shqiptar. Është e kuptueshme që tema bosht e studimit nuk lejon autorin të merret me hollësi me politikën e shteteve që e kishin përbërë Aleancën Ballkanike, por për sqarimin më të thellë të problematikës do të ishte mirë të prezantoheshin edhe disa dallime të rëndësishme midis tyre sa i përket çështjes shqiptare. Janë përshkruar dhe janë analizuar mirë mosmarrëveshjet midis grupacioneve të ndryshme politike dhe ideologjike të shqiptarët kundrejt qëndrimit të drejtë ose më saktë për qëndrimin më pak të dëmshëm për shqiptarët në muajt tragjikë të okupimit të huaj. Hezitimet ndër elitën intelektuale dhe politike shqiptare janë paraqitur dhe zbuluar mirë, si edhe shkaqet për shfaqjen e tyre. Vlera e studimit qëndron edhe në përpjekjet e autorit t'u japë përgjigje pyetjeve më të rëndësishme të lidhura me nacionalizmin shqiptar, me ndërtimin e shtetit, pengesat dhe vonesat në këto procese, gjithmonë me një analizë krahasuese me proceset e ngjashme të popujt e tjerë ballkanikë. Sqarimi i dallimeve ndërmjet rrymave të ndryshme ideologjike, shpesh të motivuara edhe nga përkatësia fetare, që ka ndikuar edhe për orientimet e tyre ndaj shteteve të tjera në kohën e Shpalljes së Pavarësisë dhe në vitet pas këtij akti shton nivelin e analizës. Nuk mund të mos pajtohem plotësisht me përfundimet e autorit për rolin dhe problemet e nacionalizimit shqiptar, me të cilat u ndesh ai në kohën e Shpalljes së Pavarësisë. Pika e tretë e kapitullit të dytë, *Pikëpamjet e nacionalizmit shqiptar për mënyrën e ndërtimit të shtetit dhe baza sociale e tij*, trajton çështje shumë të rëndësishme sepse prek thelbin e doktrinës së nacionalizmit shqiptar. Në ndonjë mënyrë, ky paragraf relativisht i shkurtër në krahasim me pjesët e tjera të studimit, shumë saktë i tregon sfidat e rënda para patriotëve shqiptarë në periudhën 1912-1913, tregon për bazën e ngushtë ekonomike dhe sociale, mbi të cilën duhej të mbështeteshin nationalistët shqiptarë, që situata objektive e kishte vështirësuar pa masë arritjen e qëllimeve të mirëfillta të nacionalizmit shqiptar. Tema për nacionalizmin irredentist shqiptar ka rëndësi të madhe edhe për historiografinë bullgare dhe për politikën e atëhershme bullgare, sepse pikërisht me grupacionin e “irredentistëve shqiptarë”, Bullgaria ka pasur kontakte të ngushta dhe të vazhdueshme. Me shumë objektivitet janë përshkruar proceset dhe dallimet ndër rrymat kryesore shqiptare,

orvatjet dhe dyshimet rreth aleancave të mundshme rajonale gjatë vitit 1913. Në këtë periudhë, siç tregon me të drejtë të plotë autori, pikërisht fragmentarizmi ndër udhëheqësit dhe grupacionet politike shqiptare e kanë penguar krijimin e një vije më të qartë sa i përket mundësive për formimin e aleancave rajonale. Do të ishte mirë, nëse e lejojnë dokumentet natyrisht, të përfshihen më shumë fakte dhe analiza për rolin e rrethanave ekonomike dhe sociale për formimin e këtyre grupacioneve.

Në **kreun e tretë** gjithashtu trajtohen dhe analizohen ngjarje dhe procese me rëndësi të veçantë për ekzistimin e Shqipërisë si shtet. Autori i ka shpeguar në mënyrë të plotë arsyet për dështimin e nacionalizmit shqiptar në vitin 1914, si edhe rrezikun për shkatërrimin e shtetit të brishtë shqiptar nën presionin e sfidave të brendshme dhe të jashtme. Janë prezantuar me hollësi grupacionet e reja ndër faktorin politik shqiptar, motivet e tyre, si edhe programet dhe mendimet për shpëtimin e Atdheut dhe për të ardhmen e tij. Interesim i madh paraqet hulumtimi i prirjeve nacionaliste të popullsisë nga rajonet e ndryshme të Shqipërisë që mund të shpjegojë mbështetjen për një apo tjetër drejtim politik. Meriton vëmendje edhe trajtimi i çështjeve arsimore e kulturore dhe rëndësia e tyre për zhvillimin e kombit shqiptar. Gërshetimi i këtyre çështjeve me luftërat politike tregon më qartë arritjet dhe problemet e nacionalizmit shqiptar, si edhe përpjekjet dhe vështirësitë para shtetndërtimit me të cilat ballafaqoheshin atdhetarët shqiptarë. Janë shqyrtuar edhe orientimet dhe pozicionet e grupacioneve politike shqiptare ndaj Fuqive të Mëdha dhe ndaj palëve në dyluftimin e ashpër që kishte kapluar Kontinentin e Vjetër. Sqarimi i orientimeve gjeopolitike të grupacioneve shqiptare, kryesisht pas formimit të “Krahinës Autonome të Korçës”, është me rëndësi të madhe, por studimi do të fitonte edhe më shumë nëse prezantimi i marrëdhënieve të komplikuar shqiptaro-greke-franceze në rajonet jugore dhe juglindore të shtetit shqiptar ishin vënë në krahasim me politikën e Fuqive Qendrore ndaj këtij formacioni autonom.

Përfundimi i “Luftës së Madhe” i kishte vënë prapë shqiptarët para rrezikut të copëtimit dhe të dominimit të huaj. Pikërisht kjo periudhë tranzicionale me sfida të mëdha para rimëkëmbjes së Shqipërisë si shtet i pavarur prezantohet dhe analizohet në **kreun e katërt** të studimit. Në kushtet e reja gjeopolitike, kur aktorë kryesorë sa i përket çështjes shqiptare nga dekadat e mëparshme, si Perandoria Osmane dhe Austro-Hungaria, nuk ekzistonin më dhe ishin pjesërisht apo plotësisht të shpërbëra, rrymat politike shqiptare duhej të kërkonin mbështetës të rinj.

Ky fakt ka çuar deri në riorientimin e rrymave të nacionalizmit shqiptar, por në këtë riorientim kundrejt Fuqive të Mëdha, të dala fituese nga Lufta, Shqipëria ka pasur pozicione më të këqija në krahasim me kundërshtarët më të mëdhenj të tërësisë territoriale shqiptare, pra me Serbinë dhe Greqinë. Edhe në këtë periudhë, arsyetohet studiuesi, nacionalizmi shqiptar ka vazhduar të përballej me pengesat e vjetra të lidhura me dallimet dhe mosmarrëveshjet krahinore, fisnore, me prirjet fetare dhe me disa probleme të lindura nga gjendja e dobët në fushën e arsimit. Autori tregon edhe disa përmirësime në trojet shqiptare për shkak të Luftës – ngritja e ndjenjës kombëtare te shqiptarët, përfitimi i përvojës administrative nga pjesëmarrja në administratat e forcave okupuese, disa zhvillime pozitive në përhapjen e shkollimit në gjuhën shqipe, formimi i një shtrese të re intelektualësh. Këto procese i kishin përmirësuar gjasat për ribërjen e Shqipërisë dhe ndërtimi i një shteti më të përforcuar. Autori ka të drejtë të plotë kur konstaton që nacionalizmit shqiptar i kishte munguar një qendër unifikuese, e cila të ishte në gjendje të merrte përpunimin e një programi realist dhe jetësimin e tij.

Edhe në pazarllëqet e Parisit gjatë vitit 1919, ku janë bërë gabime fatale për të ardhmen e Evropës në vend që të qetësohej kontinenti evropian, për shkak të politikave të padrejta dhe grabitëse, shqiptarët papë ndodheshin në rrethana të jofavorshme dhe sërish u shfaqën ndarjet dhe kundërshtimet në lidhje me orientimin e duhur ndaj një fuqie të jashtme. Këto zhvillime janë përshkruar dhe analizuar në nivelin e duhur. Dhjetori i vitit 1919 ka sjellë një marrëveshje ndërkombëtare që e ka cenuar sovranitetin e shtetit shqiptar dhe ka lejuar rreziqe të reja për tërësinë territoriale të Shqipërisë. Ky konstatim tepër i drejtë i autorit është konfirmuar pothuajse menjëherë, kur në muajt e parë të vitit 1920, fqinjët e Shqipërisë kanë ndërmarrë përpjekje për ta copëtuar Shqipërinë. Duke u bazuar mbi faktet dhe ngjarjet në këtë periudhë të pasluftës, autori ka arritur në përfundimin se edhe në kushtet e reja nacionalizmi shqiptar kishte vuajtur nga sëmundjet e vjetra, dhe pse me disa përparime ideologjike. Për këtë periudhë (1918-1920) duket i bazuar dhe i arsyetuar konkluzioni kryesor i autorit, që ideologjia kombëtare te shqiptarët kishte hyrë në fazën e saj të tretë që u manifestua më së miri me organizimin dhe me vendimet e marra në Kongresin e Lushnjës në janar 1920.

Kreu i pestë trajton sfidat para ribërjes së shtetit shqiptar. Që nacionalizmi shqiptar kishte marrë fuqi në krahasim me ngjarjet para Luftës së Parë Botërore dëshmohej edhe nga fitoret e vitit 1920 ndaj

forcave centrifugale dhe madje ndaj forcave italiane. Këto fakte përputhen me pohimet e autorit për ngritjen e nacionalizmit shqiptar në një shkallë më të lartë, edhe pse përçarjet kanë vazhduar të luanin rolin e tyre negativ për stabilizimin e gjithanshëm të shtetit shqiptar. Zhvillimi i jetës politike në Shqipëri ka vazhduar me formimin e protopartive të para politike në Shqipëri dhe me zgjedhjet e para parlamentare. Autori i ka analizuar në mënyrë të përsosur këto ngjarje e procese dhe ka paraqitur mjaft argumente që këto parti kanë qenë larg standardeve të nevojshme dhe nuk mund të flitet për organizata moderne politike, sepse kundërshtimet e vjetra mbi baza personale dhe krahinore kanë qenë faktorët dominantë, por prapëseprapë kemi të bëjmë me një etapë të re në jetën politike shqiptare, ku filluan të shfaqeshin edhe grupimet politike mbi bazën e origjinës sociale. Ngritja e nivelit organizativ të shtetit shqiptar ka parandaluar përpjekjet për kantonizimin e vendit dhe ka evituar rrezikun e një copëtimi të ri të territoreve shqiptare. Lëvizjet autonomiste në jug dhe në veri të vendit në të vërtetë kanë qenë tepër të rrezikshme për trupin ende të pakalitur shtetëror dhe autori e ka argumentuar shumë mirë tezën e tij. Në këtë kapitull bën një përshtypje të mirë përpjekja për nxjerrjen në pah të kontributit të grave për shtimin e ndjenjave kombëtare te popullsia shqiptare. Autori trajton një çështje me rëndësi, që shpesh shpërfillet nga studiues të tjerë. Konkluzioni i autorit që edhe në këtë periudhë nacionalizmi shqiptar ka vazhduar të tregonte dobësitë e tij të vjetra të lidhura me ashpërsimin e kontradiktave personale, mbështetet edhe nga ngjarjet e dhjetorit 1921. Dr. Kadria në mënyrë të qartë ka treguar rrezikun në rritje për lidhjen e forcës politike drejtpërdrejt me forcat ushtarake që kanë përkrahur ndonjë politikan. Kjo tendencë ka qenë shenjë e rëndësishme se jeta politike në Shqipëri po rrëshqiste drejt luftës vëllavrasëse dhe vlerësimet e studiuesit për faktorët që e kanë shkaktuar këtë gjendje bazohen plotësisht mbi faktet dhe proceset e hulumtuara. Autori analizon dhe përçarjen kryesore ndër nacionalistët shqiptarë në këtë periudhë, që ishte e lidhur me qasjen dhe politikën e shtetit shqiptar ndaj shqiptarëve jashtë atdheut që ndodheshin nën presion të madh dhe shpesh janë terrorizuar nga pushteti serb dhe nga ai grek. Njëra prej rrymave kishte ndarë mendimin se detyra kryesore e nacionalizmit shqiptar duhej të ishte përforcimi i shtetit të dobët shqiptar dhe pastaj të ndërmerreshin masa për përmirësimin e gjendjes së tyre politike në shtetet fqinjë dhe në vend të parë në Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene, derisa rryma tjetër ka insistuar për përdorimin e luftës së

armatosur pa vonesa. Këto qëndrime, që kanë sjellë edhe ndarje të rënda në politikën shqiptare, nuk kanë qenë vetëm një dukuri shqiptare, sepse pikërisht në këto vite procese shumë të ngjashme janë zhvilluar edhe në politikën e brendshme bullgare, ku gjithashtu kanë sjellë pasoja tragjike. Në fund të këtij kapitulli janë bërë disa konkluzione të rëndësishme, që gjithashtu janë argumentuar – shndërrimi i Ahmet Zogut në figurën kryesore të politikës shqiptare dhe përforcimi e përhapja e ndjenës kombëtare në masat e gjera të popullsisë.

Kapitujt e gjashtë dhe të shtatë shqyrtojnë tema shumë të rëndësishme për nacionalizmin shqiptar – raportet me institucionet fetare dhe me komunitetet e tjera etnike në Shqipëri. Këto hulumtime kanë një rëndësi të veçantë, sepse lidhjet, niveli i bashkëpunimit mes nacionalistëve shqiptarë dhe institucionet e besimeve fetare, si edhe frymëzimi i institucioneve fetare me ndjenjën kombëtare dhe atdhedashëse kanë pasur një domethënie të jashtëzakonshme për zhvillimin e nacionalizmit shqiptar, për shtetndërtimin dhe për ndalimin e propagandave dhe të ndikimeve të huaja. Nacionalizmi shqiptar është ballafaquar me shumë sfida në këtë drejtim, sepse dështimi eventual në përpjekjet për krijimin e një shteti laik, që ka qenë mundësia e vetme në këto rrethana dhe sipas traditave shqiptare, dhe lejimi i dominimit të ndonjë institucioni fetar në jetën politike, pa dyshim, do të shkatërronte shtetin dhe kombin shqiptar që nga fillimet e nacionalizmit.

Edhe më vonë, gjatë stabilizimit të ngadalshëm të pozicioneve të nacionalizmit shqiptar, marrëdhëniet e institucioneve fetare me institucionet shtetërore dhe me rrymat e ndryshme politike kanë qenë një çështje shumë delikate. Përfshirja e krerëve fetarë në jetën politike dhe në proceset e vendimmarrjes, prapë ka sfiduar arritjen e balancës midis respektimit të dëshirave të institucioneve fetare dhe ruajtjes së sovranitetit të shtetit. Nuk mund të mos përmendet, se si në etapat e mëparshme, studiuesi nuk është hezitur që të trajtonte edhe disa dukuri negative që kanë pasur vend në institucionet fetare, ku rryma të veçanta kanë manipuluar me ndjenjat e besimtarëve me qëllim përfitime personale ose duke vepruar nën petkun e interesave të huaja.

Pra, nacionalizmi shqiptar gjatë tërë kësaj kohe duhej të reagojë dhe të vepronte me maturi dhe në mënyrë tepër delikate sa i përket çështjes fetare, sepse çdo hap i gabueshëm do të çonte shtetin dhe kombin shqiptar buzë gremisë. Prandaj studimi i dr. Kadrisë meriton vlerësime të larta, sepse ka trajtuar me përkushtim këto çështje tepër të rëndësishme

për nacionalizmin shqiptar. Pikërisht këto arritje të nacionalizmit shqiptar dhe zgjidhja me sukses e çështjes së pavarësisht të institucioneve fetare në Shqipëri janë ndër treguesit më të mëdhenj për pjekurinë e tij, pavarësisht mangësive të tjera.

Sa i përket raporteve midis nacionalizmit shqiptar dhe minoriteteve, duhet të theksohet që autori në pohimet e tij thekson që të drejtat e minoriteve në Shqipëri kanë qenë të mbrojtura në mënyrë shumë të kënaqshme për rrethanat e kohës, edhe pse në shtetet fqinjë ka pasur terror dhe presion të përditshëm kundër popullsisë shqiptare, që ka qenë shumë më e madhe në numër në krahasim me pakicat e ndërsjella në Shqipëri. Përveçse mund të pajtohemi me autorin, mund të bëhet edhe një rekomandim për këtë kapitull – të shqyrtohen të gjitha minoritetet pa përjashtim dhe marrëdhëniet e tyre me shtetin shqiptar.

Kapitulli i fundit i studimit, që trajton ngjarjet në Shqipëri në periudhën 1922-1924, gjithashtu prezanton faktikisht edhe përmbledhjen e rezultateve dhe të dështimeve të nacionalizmit shqiptar në lidhje me ndërtimin e shtetit dhe të kombit. Mund të pajtohemi me studiuesin se nacionalizmi shqiptar nuk i kishte tejkaluar mangësitë e tij që buronin nga faktorë me karakter objektiv dhe subjektiv. Nacionalizmi shqiptar ka pasur suksese të rëndësishme në mbrojtjen e pavarësisë së Shqipërisë, por nga ana tjetër është dështuar në stabilizimin e shtetit shqiptar që dëshmohej nga mosrealizimi i përpjekjeve për krijimin e bazës kushtetuese dhe ligjore të shtetit. Duke u përpjekur për të zgjidhur deri diku problemet më thelbësore të kombit dhe të shtetit, nacionalizmi shqiptar është përçarë thellë kryesisht në bazë të ambicieve dhe të urrejtjes personale. Faktikisht, siç del nga studimi, vetëm sa i përket “Çështjes së Kosovës” midis përfaqësuesve të nacionalizmit shqiptar ka pasur dallime me prapavija strategjike, derisa në sfondin e luftërave politike kanë dominuar thjesht ambiciet personale dhe grupe. Këto kundërshtime të ashpra kanë eskaluar në dhunë të hapur që ka vënë shtetin shqiptar para sfidave të reja edhe në periudhën, e cila nuk mbulohet nga studimi.

Përfundime

Arritjet shkencore të studimit të dr. Kadrisë janë të shumta dhe me vështirësi mund të numërohen plotësisht. Në vend të parë, mund të shënohet që ai, në mënyrë kritike, i shqyrton mendimet, qëndrimet e historiografisë shqiptare për këto ngjarje, procese dhe personalitete. Gjatë

prezantimit të opinionit të tij nuk heziton që t'i thyejë tabutë dhe disa mite, të krijuara për shkak të ideologjive të ndryshme. Punimi është shumë i pasur me fakte, por me rëndësi janë analizat, sepse do të ishte vështirë të silleshin fakte të reja, ngaqë këto ngjarje dhe procese janë trajtuar nga shumë studiues dhe ngjarjet njihen me shumë hollësi. Pikërisht analizat e autorit kanë krijuar një studim të veçantë me vlera të mëdha shkencore. Sukses i plotë ka edhe përdorimi i klasifikimit të nacionalizmit shqiptar, përmes të cilit bëhen ndarjet e periudhave dhe organizimi i fakteve dhe i ngjarjeve. Prezantimi dhe analizimi i rolit të faktorëve fetarë dhe disa ndikime negative të tyre në fuqizimin e shtetit dhe të institucioneve gjatë kësaj periudhe gjithashtu është ndër meritat e këtij studimi. Është e arsyetuar që studimi merret kryesisht me nacionalizmin shqiptar brenda kufijve të Shqipërisë Londineze, sepse ai ka pasur të bënte me krijimin dhe pavarësimin e shtetit shqiptar, që përkon me detyrat e punimit, por studimi mund të zhvillohet edhe më shumë me analiza më të zgjeruara për veprimet e nacionalistëve shqiptarë në zonat e okupuara – Kosovë, Maqedoni etj. Në përgjithësi, tezat e autorit ngrihen mbi referenca të besueshme dhe nuk shkëputen nga interpretimi realist i fakteve. Shpesh burimeve dhe autorëve të ndryshëm u bëhet edhe analizë kritike, sepse vlerësimi më realist mund të arrihet vetëm përmes krahasimit të pikëpamjeve të ndryshme. Natyrisht, tema shumë e gjerë e studimit nuk mund të mbyllet në asnjë mënyrë, sepse jo vetëm që ka diskutime dhe mospajtime në lidhje me disa fakte dhe procese të ndriçuara ende mirë nga shkenca historike, por nuk duhet të harrohet se edhe për shumë teza mund të ketë trajtime, analiza dhe konkluzione të ndryshme, që varet edhe nga paradigmat e ndjekura. Përfundimi i përgjithshëm është se monografia “*Nacionalizmi shqiptar në vitet 1912-1924*” me autor dr. Sali Kadria është një studim i përgatitur shumë mirë, që ka vlera të mëdha shkencore dhe është i përshtatshëm për zhvillimin e aftësive akademike të dr. Sali Kadrisë.

Asst. Prof. Anton Panchev, Ph.D.
Department of Balkan Studies
Sofia University "St. Kliment Ohridski"

Sofje, 30 prill 2020

